

**“Rrjeti I Ujesjellesit Te Fshatrave Zhame, Gramsh, Konjat, Dushk, Thanasaj Njesia  
Administrative Dushk, Bashkia Lushnje ”**

**Plani i sigurimit dhe i koordinimit ne pune.**



**POROSITESI**  
**Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lushnje sha**

**KONSULENTI**  
**EBS sh.p.k.**

---

## PËRMBAJTJA

Përmbajtja.....	i
<b>1 HYRJE .....</b>	<b>2</b>
1.1 Qellimi dhe objektivat e Planit te Sigurimit dhe Koordinimit ne Pune si dhe kuadri ligjor. ....	2
<b>2 Pershkrimi i Projektit.....</b>	<b>4</b>
<b>3 DISPOZITA TE PERGJITHSHME .....</b>	<b>5</b>
3.1 PERDORIMI I DETYRUESHEM I PAJISJEVE TE SIGURIMIT TEKNIK .....	6
3.2 MJEDISI I VENDIT TE PUNES .....	9
<b>4 Termat e Manualit per Sigurimin Teknik dhe Shendetit ne Pune. ....</b>	<b>12</b>

## 1 HYRJE

Punimet per ndertimin e rrjetit te Ujesjellesit te 5 fshtrave ne NJA Dushk ne bashkine Lushnje konsistojne ne ndertimin e 2 puseve te shpimit per marjen e ujit, ndertimin e nje stacioni pompash dhe nje depo grumbulluese me volum 400 m<sup>3</sup>, ndertimin e dy depove me volum 300 m<sup>3</sup> dhe 1000 m<sup>3</sup>, ndertimin e linjave te dergimit dhe linjave te rrjetit shperndares per te 5 fshatrat e NJA Dushk ne bashkine Lushnje.

### 1.1 Qellimi dhe objektivat e Planit te Sigurimit dhe Koordinimit ne Pune si dhe kuadri ligjor.

#### a. Pershkrimi i qellimit dhe objektivat e Planit te Sigurimit dhe Koordinimit ne Pune.

**Qellimi i Planit:** Ky Plan ka per qellim te percaktoje rregulla te plota per administrimin e sigurise dhe shendetit ne pune ne menyre qe te ofrohet nje vend pune i sigurt dhe i shendetshem, si dhe te sigurohet qe stafi i Kontraktorit dhe persona te tjere qe mund te ndodhen ne zone gjate procesit te punes, te mos ekspozohen ndaj rrezikut qe mund te sjelle veprimtaria e Kontraktorit.

**Objektivat e Planit:** Objektivat e ketij Plani konsistojne ne analizimin e faktoreve lokale e negative qe percaktojne masat qe duhet te merren ne lidhje me:

- Sigurine e shendetit te punonjesve ne pune,
- Sigurine teknike gjate procesit te punes
- Dhenien e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative,
- Percaktimin e rregullave te sigurimit teknik,
- Kontrollove te nevojshme mjekesore dhe teknike,
- Percaktimin e te drejtave dhe detyrave te punedhenesit dhe punemarresit ne kete objekt,

#### b. Kuadri ligjor ne lidhje me Sigurimin dhe Koordinimin ne Pune.

1. Ligji nr.8417,date 21.10.1998 "Per Kushtetuten e Republikes se Shqiperise".
2. Ligji nr.date 18.02.2010.Ne mbeshtetje te neneve 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutes,me propozimin e Keshillit te Ministrave.
3. Ligji nr.7961 date 12.07.1995,"Per Kodin e Punes ne Republiken Shqiperise" ndryshuar me ligjin nr.8085 date 13.03.1996, dhe ligjin nr 9125 date 29.07.2003.
4. Ligji nr.7147 date 30.10.2003"Per Ratifikimin e Konventes nr 155 te Organizates Nderkombetare te Punes per "Sigurine ne Pune shendetin dhe ambientet e punes1981.
5. Ligji nr 9148 date 30.10.2003 "Per ratifikimin e Protokollit te vitit 2002 te Konventes me nr 155 te Organizates Nderkombetare te Punes per "Sigurine ne Pune, shendetin dhe ambientin e punes 1981.
6. Vendimi i Keshillit te Ministrave nr 692 date 13.12.2001"per masat e veqanta te sigurimit dhe mbrojtjes se shendetit ne pune "ndryshuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr 742 date 06..11.2003.

7. Vendimi i Keshillit te Ministrave nr.207,date 09.05.2002 “Per percaktimin e punve te veshtira ose ose te rrezikshme “.
8. Vendimi i Keshillit te Ministrave nr 461, date 22.02.1998 “Per rregjistrin qe mbane punedhenedesi per aksidentet ne pune dhe semundjet profesionale “.

Marrja e masave mbrojtese individuale dhe kolektive ne pune eshte e detyrueshme sepse ndihmon ne mbrojtjen e shendetit te punonjesve dhe garanton sigurine ne pune.

---

## 2 PERSHKRIMI I PROJEKTIT.

### *a) Pershkrimi i Qellimit dhe Objektivit te projektit*

Qellimi i ketij projekti eshte ndertimi i rrjetit te ujesjellesit te 5 fshatrave te njesiase administrative Dushk ne Bashkine Lushnje.

Zbatimi i projektit konsiston ne ndertimin e dy pusshpimeve te reja, nje stacioni pompash, nje depo grumbulluese me volum 400 m<sup>3</sup>, linjat e dergimit nga puset tek STP dhe nga STP tek depot e fshtrave, stacionin e klorinimit te ujit, dy depo me volum 300 m<sup>3</sup> dhe 1000 m<sup>3</sup>, linjat e rrjetit shperndares te 5 fshtrave, matesat e ujit per afro 1700 kliente, etj permes percaktimit te zgjidhjes me te mire teknike e cila permbush objektivin dhe siguron nje zgjidhje te qendrueshme, duke marë në konsiderate mundësitë e realizimit bazuar në kriteret tekniko-ekonomike, social mjedisore;

### *2) Manuali per Sigurimin dhe Koordinimit ne Pune.*

Per zbatimin e Planit te sigurimit dhe Kooridnimit ne Pune hartohet nje manual per Sigurimin dhe koordinimin ne pune nga Punemarresi.

Punemarresi duhet te pregatite kete manual I cili te zbatohet ne baze te kuadrit ligjor te mesiperme ne te gjitha ndertimet civile dhe montime.

Me poshte jepet nenet kryesore te ketij manuali te cilat duhet te kihen paraysh gjate hartimit te manualit te PSK qe do te hartoje Punedhenesi ne fillim te punes per zbatimin e ketij projekti

### 3 DISPOZITA TE PERGJITHSHME

#### NENI 1

**Objekti:** Ky manual ka per objekt percaktimin e masave, qe synojne garantimin e sigurise dhe shendetit ne pune te punemarresve.

**Masat:** Shoqeria ne cilesine e punedhensit do te ndermarr te gjitha masat qe mund te zbatohen nga ana teknike dhe qe provoja ka treguar se jane te nevojshme per parandalimin e aksidenteve ne pune ose semundjeve profesionale ne lidhje me natyren e punes, bazuar kjo ne nenin 68 te kodit te punes.

#### NENI 2

##### **Pagimi i Demit:**

1. Shoqeria duhet te paguaj diferencen midis demit dhe shperblimit qe merr punemarresi nga sigurimet shoqerore, kur aksidenti apo semundja profesionale eshte pasoje e fajise se rend e punedhensit .
2. Kur Shoqeria nuk e ka regjistruar punemarresin ne sigurime shoqerore, ai duhet te perballoje te gjitha shpenzimet qe ka bere punemarresi si rezultat I aksidentit ose semundjes profesionale si dhe te gjitha demet si pasoje e mos regjistrimit.

#### NENI 3

**Rregullat e sigurimit teknik:** Shoqeria per te parandaluar aksidentet ne pune duhet te percaktoje qart rregullat e sigurimit teknik. Punemarresi eshte i detyruar te verifikojne nese skelet ne kushte te mira teknike per fillimin e punes, nese punemarresi veren qe skela nuk eshte e pershtatshme nuk eshte bere brenda parametrave te duhur dhe ve ne rrezik jeten e punemarresit, ai eshte i detyruar te mos filloje pune por te njoftoje personat pergjegjes

#### NENI 4

**Sinjalet:** Shoqeria do te vendos sinjale te dallueshme ne cdo vend pune qe paraqet rrezik per jeten dhe shendetin e punemarresave.

#### NENI 5

**Kontrollet Mjeksore:** Duke mare parasysh rreziqet e vecanta qe mund te vijne nga natyra e punes, Shoqeria do te organizoje kontrole periodike mjeksore te punemarresve te pakten nje here ne vit.

#### NENI 6

**Raporti Mjeksore:** Punemarresit qe punojne ne sektorin e prodhimit te Shoqerise duhet te jene te pajisur me raport mjeksor perpara se te punesohen.

#### NENI 7

**Percaktimi i vendit te punes:** Shoqeria per te mbrojtur jeten dhe shendetin e punemarresve ne pune, vendos punemarresit e tij sipas:

- a) Aftesive profesionale
- b) Gjendjes shendetsore bazuar ne viziten mjeksore te kryer nga mjeku I kompanise, para pranimit ne pune.
- c) Moshes.
- d) Gjinise.

#### NENI 8

**Higjena dhe masat perkatese:** Shoqeria do ti Shpjegoje punemarresve te ekspozuar ndaj rrezikut, nevojen e zbatimit te masave te sigurise teknike dhe higjenes.

### **3.1 PERDORIMI I DETYRUESHEM I PAJISJEVE TE SIGURIMIT TEKNIK**

Duke u bazuar dhe ne nenin 24 pika 1 dhe 2 te kodit te punes punemarresi eshte I detyruar te perdor veshjet dhe veglat e sigurimit teknik ne pune si me poshte vijojne:

- a. Punemarresi kryen me kujdes punen qe I ngarkohet
- b. Punemarresi per kryrejen e punes duhet te perdor sipas rregullave te caktuara mjetet e punes, aparaturat mjetet e punedhensit dhe pajisjet e vena ne dispozicion te tij.

#### **NENI 9**

**Organizimi i deges teknike te shoqerise:** Administratori u ngarkon pergjegjesve te grupeve te montimit te drejta dhe detyrime te ndryshme ,ne pajtim gjithmone me udhezimet e Shoqerise,si dhe detyrimin per ruajtjen e sigurimit dhe te parandalimin e aksidenteve ne pune.

Inxhinerat e sigurimit teknik duhet te japin udhezimet lidhur me masat per sigurimin ,te inspektoje dhe te raportojne rastet problematike qe mund te ndodhin gjate kryerjes se punes .Cfar do lloje pasigurie do te raportohet tek administrator i shoqerise I cili me pas mund te marre masa ndeshkuese.

#### **NENI 10**

**Te drejtat dhe detyrimet e punedhensit:**

- a. Hartimi dhe njoftimi i procedurave te organizimit dhe sigurimit te vendit te punes.
- b. Perpilimi i shkresave ne procedurat e sigurimit
- c. Analiza dhe plotesimi i te gjitha formularve qe u perkasin aksidenteve ne pune dhe ndodhive te tjera te rrezikshme qe lidhen me to
- d. Bashkerendimi i stervitjes se personelit

**Te drejtat dhe detyrimet e punemarresit.**

Punetoret duhet te perdorin mjetet e sigurise personale gjate te gjitha kohes se punes. Perdorimi I detyrueshem te mjeteve te sigurise personale nga ana e punonjesve duhet te jete si me poshte:.

- a. Veshja e Jelekut
- b. Vendosja e rripit te sigurimit te gjate montimit
- c. Veshja e kepuceve te sigurise kunder rreshqitjes
- d. Vendosja e kaskes (kokores)ne cdo kohe
- e. Perdorimi i dorezave
- f. Vendosja e syzeve

Punonjesit kane per detyre gjate orarit te punes te perdorin veshjet dhe veglat e sigurimit teknik sidomos gjate punes ne skela ne montimin e fasadave te jashtme (ne raste te moszbatimit te ketije urdheri do te penalizohen personat pergjegjes.)

**Punemarresi ka te drejte:**

1. Te kerkoje plotesimin nga ana punedhenesit te kushteve qe percaktojne rregulloren e teknikes se sigurimit dhe mbrojtjes ne pune.
2. Te mose zbatoje urdherat e dhena ose detyrat qe i ngarkohen kur sheh qe egzistone rreziku I aksidentit dhe masat parandaluese per menjanimin e tije jane te pa mjaftueshme
3. Gjate montimit te dyerve, dritareve, vetratave ne fasadat e jashtme duhet te montohen duke respektuar rregullat e sigurimit teknik ,ne cdo moment punetori te kete vendosur pajisjet e mesiper.
4. Ndalohet lenja e elementeve te fasadave pa u fiksuar perfundimisht ose pa marr masa per per forcimin.
5. Ne rastet e punimit ne lartesi punetoret qe montojne fasada xhama duhet te pajisen me rripa sigurimi te duhet ti mbajne te lidhur vazhdimisht.
6. Ndalohet rreptesisht vendosja e xhamave dhe elementeve te fasadave ne dritare te hapura dhe pa mbeshtetje sigurie
7. Punetori qe punon ne fasada ne objektet e larta duhet te pajisen me rripa sigurimi dhe me kaske
8. Ndalohet lenja e veglave te punes ne dyshemet e skelave ,veglat e imta te mbahen ne kaseta e posacme dhe shabllonet etj, lihen horizontalisht ne dyshemen e skelave, pa penguar levizjen
9. Gjate saldimit punetoret duhet te pajisen me size mbrojtese
10. Punonjesit duhet te bejne raportim i cdo lloje problem qe mund te hasin ne kanter.

### **NENI 11**

#### **DETYRAT DHE TE DREJTAT E INXHINERIT TE SIGURIMIT TEKNIK JANE SI ME POSHTE**

1. Mbykqyrja e kryerjes se procesit te punes dhe verifikimi i pajtueshmerise me legjislacion ne fuqi qe lidhet me sigurimin dhe me ate qe kerkon punedhensi.
2. Dhenja e keshillave punonjesve per ruajtjen e sigurimit ne vendet e punes
3. Takime me drejtorin dhe pergjegjesit me qellim qe keta te fundit te informohen ne lidhje me regjimin e sigurimit
4. Kontrolli I kryerjes se procesit te punes ,zhvillimi i vizitave te herpashershme ne kantier dhe raportimi I shkeljeve te mundshme
5. Dhenja e mjeteve te sigurise personale punonjesve
6. Raporti te gjithe parregullesive qe verehen gjate procesit te punes ,duke I shoqeruar ato edhe me propozimet per veprime permirsuese
7. Cdo mbykqyres do te jete pergjegjes per dhenjen e udhezimeve te pershtatshme punonjesve qe gjenden ne mbykqyrjen dhe kontrollin e tije,ashtu si dhe per kryerjen e sigurt te procesit te punes qe lidhen me ta
8. Ne raste se ndonje punonjes nuk pranon te kryej nje pune apo te perdor ndonje vegjel aparat apo pajisje, kete refuzim do te raportoje menjeher tek pergjegjesi.

9. Përgjegjësi ose dikush nga personat e tjerë kompetent që do të merren me një raportim të tillë, do të kalojë menjëher në hetim të qeshtë.
10. Do të sigurojë rregullimin e menjëhershëm dhe pa vonesa të çfarëdo rrethane të pasigurt pune, ose
11. Nëse procedurat e mesipërme nuk e zgjidhin çështjen dhe dikush nga punonjësit vijojnë të mos pranojnë kryerjen e ndonjë pune, përgjegjësi do të hetojë çështjen në prani të punonjësit që të formulojë raportin.

### **NENI 12**

#### **Kontrollet e sigurimit dhe takimit**

1. Gjatë kohës së kryerjes së procesit të punës, përgjegjësi duhet të zhvillojë disa takime në të cilat duhet të marrë pjesë të gjithë pjesëtarët kryesorë të personelit, me qëllim që të informohen në lidhje me të gjitha problemet që i përkasin sigurimit.
2. Qëllimi i këtyre takimeve që organizon inxhinieri i sigurimit është koordinim dhe shkëmbim i mendimeve me personelin kryesor si dhe përiulimi i dokumentave përkatëse lidhur me të cilin firmoset nga të gjithë pjesëmarrësit.
3. Inxhinieri i sigurimit ose përgjegjësi duhet të kryejë kontrolle të herpashershme me qëllim që të vërtetojë nëse sjelljet dhe veprimet janë ose jo në pajtim me të gjitha rregullat e sigurimit. Nëse inxhinieri i sigurimit ose përgjegjësi i grupit vërteton rastet dhe sjelljet jo të mira do të kryhet një takim me qëllim që ato të analizohen dhe të merren vendime për masat e korrigjimit të gjendjes, neqoftëse gjatë inspektimit që pas takimit inxhinierat e Sigurimit ose përgjegjësit e grupit vërteton se nuk janë zbatuar vendimet që u morën për korrigjim atëherë këto e raportojnë menjëher tek administratori.
4. Juristi ka të drejtë të shkojë për inspektim të herpashershëm në kanter për të ndjekur ecurinë e zbatimit teknik nëse gjatë inspektimit juristi konstaton shkelje të rregullave të sigurimit ky i fundit mbanë një proces verbal i cili firmoset nga palet. Me pas do të vendoset përcaktimi i masave ndëshkuese ndaj personave përgjegjës.

### **NENI 13**

#### **Raportimi i Mospajtit**

1. Në rastet se vërtetohet kryerja e procesit të punës në kundërshtim me rregullat e sigurimit, inxhinieri i sigurimit duhet të përgadis dhe të nënshkruajë një "Raport Mospajtimi" në të cilin do të përshkruajë ku qëndron mospajtimi do të përcaktojë veprimet e kerkuara për ndreqjen e situatës. Këto raporte derzojnë tek administratori.
2. Do të duhet të ndermarrë menjëher veprimet e domosdoshme për të rregulluar gjendjen. Inxhinieri i sigurimit, juristi i montimit ose ndonjë nga bashkëpunëtorët e tij, do të vlerësojë dhe do të kontrollojë nëse janë kryer veprimet në fjalë për ndreqjen e gjendjes, në vijim do të shenojë afatet përkatëse për ndreqjen e gjendjes në raportin e mospajtit.
3. Në rastet shkaktohet aksident ky duhet të raportohet tek inxhinieri i sigurimit, ky raport duhet të bëhet diçka që u shkaktoi, me qëllim që të kryhen kerkimet e duhura. Sapo të perfundojë procesi i punës, inxhinieri i sigurimit duhet të informohet për të gjithë procesin e punës së kryer.
4. Mund të hartohet një raport statistikor lidhur me aksidentet e shkaktoara gjatë kryerjes së procesit të punës. Drejtori i përgjithshëm dhe përgjegjësit e sektorit që përgjigjen për

perfundimin e procesit te punes se kryer dhe te mbahet nje kopje e raportimit te mesiperm me qellim qe te formuloje nje metodologji parandalimi te aksidenteve ne pune .

5. Duhet te plotesohet dhe te shqyrtohen te gjitha dokumentat perkatese te sigurise .Te gjitha aksidentet duhet te analizohen, ndersa raporti duhet ti kaloje per gjykim komisionit perkates me qellim shqyrtimin e metejshem dhe marrjen e vendimeve perkatese.

#### **NENI 14**

##### **Inspektimi Brenda Shoqerise**

1. Do te zhvillohen inspektime te herpashershme te te gjitha mjediseve te punes neper kantiere ,perfshi ketu dhe ato te ndertesave ,konstrukteve ,veglave ,makinerive dhe pajisjeve ose praktikave te punes.
2. Mekanizmat, vegla dhe elementet e pajisjeve inspektohen sipas keshillave te konstruksionit ose siq percaktohet ndryshe nga kerkesat ligjore.Inspektimie te veqanta do te zhvillohen kur paraqitet nje rast demtimi apo aksidenti .Ne raste se gjate ketyre inspektimeve vertetohen se kushtet e punes nuk jane te sigurta ose paraqesin rreziqe, atehere ato ndryshohen apo zevendesohen menjehere.
3. Ne raste se dikush konstaton kushte pune apo veprime jot e mira ose te rrezikshme ,atehere duhet te raportoje tek pergjegjesi i grupit sa me shpejt te jete e mundur .Pergjegjesi I grupit qe merr kete raport ,merr masa per sigurimin dhe zbatimin e menjehershem te masave korigjuese.
4. Ne raste se kerkohet nje veprim urgjent per rregullimin e nje rrethane qe perben burim te drejtperdrejt rreziku per punonjesit, me kete rrezik do te perballen vetem ata punonjes qe disponojne formimin e pershtatshem dhe qe kane marr udhezime per rregullimin e rrethanave te rrezikshme te punes.

### **3.2 MJEDISI I VENDIT TE PUNES**

Shoqeria duhet te siguroje plotesimin e te gjitha kushteve te meposhtme lidhur me mjedisin e vendeve te punes.

#### **NENI 15**

1. Ne te gjitha vendet e punes do te tregohen vendet e sigurta te hyrjes dhe daljes te cilatduhet te jene te pershtatshme me rrethanat qe mbizoterojne ne vendin e punes dhe punonjesit ne keto vende nuk te perdorin ne asnje menyre tjeter hyrje apo dalje qe mund te perbejne rrezik.
2. Do te tregohen hyrje rreziku per cdo vend pune kur nje kryerje jo normale e procesit te punes ,ka te ngjar te provokoje rrezik te drejt perdrejt ndaj punonjesve dhe ku mjetet e zakonshme te daljes mund te jene te rrezikshme ose te pa sigurta.

#### **NENI 16**

##### **Kushtet e vendit te punes dhe riparimet e mundshme**

1. Vendi i punes ne te gjitha pjeset perberse duhet te pershtatet me natyren e puneve qe do te kryej aty.
2. Siperfaqja dhe vellimi i vendit te punes duhet te jene te mjaftueshme per punemarresin qe ai te kete mundesi te kryej punen ne siguri te plote dhe pa penguar qarkullimin ne mjedis.

3. Punedhensi duhet te siguroje qe objekti te jete I forte, I qendrueshem dhe ne gjendje te mire Ato duhet te mbahen vazhdimisht ne gjendje te paster ne menyre qe te siguroje pastertine, parandalimi dhe mbrojtja nga zjarri te punedhenesve dhe njerzve te tjere nga cdo lloje infeksioni .Kontrolli dhe mirmbajtja e tyre duhet te behet ne menyre periodike.
4. Objekti duhet te kontrolllohen periodikisht per te eliminuar dhe zevendesuar pjeset qe paraqesin rrezikshmeri per jeten dhe shendetin e punemarresve, makinerit ose produktete e gatshme.
5. Shoqeria ve ne dispozicion te punemarrsve te gjitha mjetet e nevojshme manuale dhe mekanike qe te letesojne mbajtjen e peshave te renda.Shoqeria nuk do te lejoje qe nje punemarres I vetem te mbaje nje peshe me te rende se 50 kg.

### **NENI 17**

#### **Ambjenti rrethues**

1. Kalimet, korridoret, dyert dhe daljet ne raste rreziku duhet te jene te lira nga cdo pengese matrialesh ose objektesh qe pengojne qarkullimin e njerezve ne rast zjarri.
2. Hapsirat apo boshlleqet te cilat perbejne rrezik per rrezimin e personave ose pajisjeve do te duhet te mbulohen posacerisht.
3. Vendet e punes qe ndodhen neper kate ose nen toke duhet te kene gjithmone shkalle me gjersi te mjaftueshme me nbeshtetes ose parmak mbajtes.

### **NENI 18**

#### ***Detyrat te drejtit dhe pergjegjesit per sigurimin teknik dhe mbrojtjen ne pune.***

##### **• Inxhineri, Tekniku i Objektivit**

1. Organizon punen ne perputhje te plote me tekniken e sigurimit ne pune ne objekt.
2. Kontrollon vete dhe ne raste te veqanta me komision te ngritur prej tij; skelat, shkallet, konstruksionet e pajisjeve ngritese,makinerit ,mjetet,dhe pajisjet e punes dhe lejon te vihen ne shfrytzim ato vetem nese jane ne perputhje me kerkesat e rregulloreve te teknikes se sigurimit ne pune.
3. Per cdo proces pune qe fillon rishtazi (montim) ben kujtesen per masat mbrojtese te cituara me siper.
4. Ka te drejte te mos filloje pune ose te urdheroje ndalimin e saje ne objekt,kur vihet re se vazhdimi I saj paraqet rrezikshmeri per jeten e punonjesve nga mungesa e mjeteve mbrojtese.
5. Pergjegjesi per sigurimin dhe shperndarjen e mjeteve mbrojtese individuale te domosdoshme per realizimin e detyres pa rrezik.
6. Nuk lejon qe procese pune te veshkira dhe me rrezikshmeri te larte te kryhen me me pak se dy punetor.
7. Informon ne vazhdimi administratorin, per veshkirsite dhe problemet qe hasin gjate zbatimit te rregullores se sigurimt teknik dhe mbrojtjes ne pune.
8. Ne punime fasada ne lartesi ndalohet puna e punetorve pa kaluar kontrollet mjeksore.

9. Gjate veshjes se fasadave ndalohet kategorikisht lenia e tyre pa ndoje lidhje siguruese.
10. Kur punohet ne lartesi me te madhe eshte e detyrueshme qe skelat te kene brezat e sigurimit te jene te mbuluara.
11. Kur punimet kryhen ne skela ne disa kate ndalohet puna me dy ose me shume punetore ne te njejtin vertikale.
12. Punetoret dhe specialistet kur paraqiten ne frontin e punes duhet te kene me vete veglat e punes dhe instrumentat e thjeshte mates ne pershtatje me detyren qe do te plotesoje. Pergjegjesi I grupit duhet te kontrolloje veglat e punes specialisteve dhe punetoreve perpara se te fillojne punen dhe te mos lejoj fillimin e saje ne raste se ata mungojne.
13. Veglat dhe pajisjet e punes qe perdorin punetoret dhe specialistet duhet te jene te rregullta dhe conform kushteve teknike apo standarteve te prodhimit, ne raste se ato jane te demtuara, te papershtatshme dhe jashte standarteve duhet te hiqen nga perdorimi.
14. Ndalohet puna me pajisje mekanike mbi skela te improvizuara.
15. Trupi I pajisjeve elektrike duhet te tokzohen kur punon ne vende me lageshtire dhe ne afersi te konstruksioneve metalike te tokzuara.
16. Kur punohet me pajisje elektrike, perdoruesi duhet te kete doreza dhe galloshe ose duhet te punoje mbi dysHEME te izoluar.
17. Kur punimet e saldimit kryhen ne lartesi duhet te perdoren skela te varura dhe brezart e sigurimit.
18. Ne raste te kryerjes se punimeve ne lartesi pa skela, punetoret duhet te pajisen me breza sigurimi, me kepuce gome dhe qanta speciale per majtjen e veglave.
19. Montatori dhe drejtuesi teknik duhet te kete matriale teknike mbi aftesine ngritese te montimit qe ndodhen ne sheshin e montimit (vinca, polispaseve, makarave, parakove, si dhe mjeteve te tjera qe sherbejne ne montimit, litarve, zingjirve gangjave etj) me qellim qe te perdore ate qe pershtatet peshe qe ai ka per te ngritur.
20. Ndalohet rreptesisht qe kabllot ose percjellesit elektrik te qndrojne shtrire neper dysHEME .Ato duhet te ngrihen mbi 2 m nga toka.
21. Ngritja e punetoreve nepermjet skelave gjithashtu dhe zbritja si dhe me anet te litarve dhe puna mbi litar eshte e ndaluar ne cdo rast duhet te perdoren shkallet.
22. Gjate kohes se punes ne djepat e varur ndalohet qendrimi I njerzve ne djep dhe ne te gjithë rrugët e kalimit, poshte tyre te rrethohen, mbyllën.

*Punedhënesi është i detyruar të respektojë kërkesat e manualit përkatës për sigurinë dhe shëndetin në punë.*

#### 4 TERMAT E MANUALIT PER SIGURIMIN TEKNIK DHE SHENDETIT NE PUNE.

Jane te detyrueshme dhe punonjesit duhet ti nenshtrohen ketyre termave dhe ti permbahen ne menyre te rrepte te procedurave te parashikuara. Mos permbajtja ose mos zbatimi i cdo termi i cdo procedure te sigurimit teknik dhe shendetit detyron ndeshkimin e punonjesit sipas denimeve qe parashikon ne Regulloren e Brendshme te Shoqerise dhe arrijne sipas rendesise se shkeljes se termave ne penaliteyin e perjashtimit.

##### TE DETYRUSHME PER PERDORIM

- Perdorimi I kaskes mbrojtese ne pune eshte I detyrueshem.



- Perdorimi i kepuceve te sigurimit kunder rreshqitjes jane te detyrueshme perdorja e tyre gjate proceseve te punes.



- Perdorimi i rrypave te sigurimit eshte I detyrueshem kur kryhen punime ne lartesi ne skela.



- Perdorimi i jelekve eshte po ashtu shume e rendesishme gjate proceseve te punes.



Perdorimi i dorezave eshte i detyrueshem per punonjesit gjate proceseve te punes me hekur dhe beton qe te mos kene kontakt.



- Përdorimi i kufjeve në raste se gjatë proceseve të punës ka zhurmë sepse mund të shkaktojë dëmtime në degjim.



- Uniforma e punës siç janë kombinoshet janë të rëndësishme sepse bëjnë dallimin e punonjësve në kantar nga njëri-tjetri që mund të jenë kalimtarë të rastit, është e rëndësishme dhe e detyrueshme për punonjësit të kenë një uniformë të caktuar.



**Per EBS shpk**

**Ing . Fahri Maho**

